# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-447334**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjykata Speciale jep nesër vendimin për ish-krerët e UÇK-së, Berisha: Meritojnë pafajësinë! \| |
| ADRESA | `https://boldnews.al/2026/09/15/gjykata-speciale-jep-neser-vendimin-per-ish-kreret-e-uck-se-berisha-meritojne-pafajesine/` |
| BURIMI | boldnews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 20:19:38 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 15 shtator 2026, 20:17:02 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bbf708a5aa898a883fc0d764208df5a1c0b4bbcd4658e68b7c93487f38a33f60` |
| TEKSTI | `aa71bdbc22f370d9647ec88d7bcf0ef55d96d3040c24430f66ec7d25678641c3` |
| PAMJA | `c8c1afe949aafd1c68fa59b14f4d195f2b7e8eadc944e5b361e85c144ae2faad` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `119e51d1ef834d8a95371f344b64661feed1a098d458108c4cd76e20c86ae188` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `9dbe3bb033f14c903d871b5f44056dbb0c7543241b7df3ea5dc415a83f1a9da2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/119e51d1ef834d8a95371f344b64661feed1a098d458108c4cd76e20c86ae188`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Gjykata Speciale jep nesër vendimin për ish-krerët e UÇK-së, Berisha: Meritojnë pafajësinë!

22:17 : 15/09/2026 në AKTUALITET, Lajmet e Dites, POLITIKE



Në prag të shpalljes së vendimit për ish-krerët e UÇK-së në Hagë, kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka shprehur pritshmërinë që Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi të shpallen të pafajshëm.

Berisha thotë se gjatë procesit gjyqësor, sipas tij, nuk është paraqitur ndonjë provë që të mbështesë akuzat ndaj tyre dhe i cilëson katër ish-drejtuesit e UÇK-së si figura të rëndësishme të çlirimit të Kosovës.

Kreu i PD-së thekson se, pavarësisht rezultatit, vendimi i gjykatës duhet respektuar. Në të njëjtën kohë, ai kundërshton çdo kërcënim ndaj Kosovës, rendit dhe sigurisë së saj që mund të lidhet me vendimin e Hagës, duke nënvizuar se Kosova nuk duhet të mbajë pasoja për një vendim gjyqësor.

**Reagimi i plotë:**

Nesër është një ditë e veçantë! Nesër në Hagë, gjykata, pas një procesi të zgjatur gjashtëvjeçar, shpall vendimin e marrë kohë më parë për ish-udhëheqësit politikë të Kosovës. Të gjithë ata që me interes të veçantë kanë ndjekur këtë proces, nuk kanë dëgjuar apo lexuar një provë të vetme që mbështet akuzat për të cilat ata u arrestuan.

Lexo edhe:

Berisha: Ka tension mes Ramës dhe Ballukut, shkak arrestimi i Gys Agasit

Berisha pas vizitës në SHBA: Kërkova ndihmë për rrëzimin e diktaturës së krimit dhe drogës

Ndaj, për çdo shqiptar, për ish-udhëheqësit politikë të Kosovës mund të ketë vetëm një vendim, pafajësinë dhe vetëm pafajësinë e tyre. Dhe urojmë që ata të kthehen të pafajshëm siç janë, kryelartë, heroj të çlirimit të Kosovës.

Por kërcënimet që i bëhen Kosovës, rendit, paqes dhe sigurisë së saj në rast të një vendimi ndryshe nga Gjykata e Hagës, janë absolutisht të papranueshme, absurde dhe të dënueshme.

TË GJITHA


Gjykata Speciale jep nesër vendimin për ish-krerët e UÇK-së, Berisha: Meritojnë pafajësinë!
22:17 : 15/09/2026


Divjaka 47 ditë protestë kundër bashkimit me Lushnjen
22:11 : 15/09/2026


BE masa të reja për të lehtësuar lëvizshmërinë e punëtorëve
22:04 : 15/09/2026


Nesër shpallet vendimi për ish-krerët e UÇK-së
21:53 : 15/09/2026


"Treni i fundit për Veliajn"/ Gazetari: Çfarë pritet pas vendimit të Gjykatës së Lartë
21:44 : 15/09/2026


"Rama e çoi Veliajn në burg"/ Hoxha: Ai është përgjegjësi kryesor për drejtësinë që kemi sot
21:30 : 15/09/2026


Aksidenti në Shkodër/ Autori i dehur i përplasjes dhe viktima ndëshkohen njësoj
21:19 : 15/09/2026

Kosova nuk mund të paguajë asgjë për një vendim gjyqësor të padrejtë!

**Etiketa:** Gjykata Speciale në Hagë | ish-krerët e UÇK-së | Kryetari i Partisë Demokratike | Sali Berisha

## Lajme të lidhura



**Berisha: Ka tension mes Ramës dhe Ballukut, shkak arrestimi i Gys Agasit**

13:52 : 14/09/2026



**Berisha pas vizitës në SHBA: Kërkova ndihmë për rrëzimin e diktaturës së krimit dhe drogës**

12:30 : 14/09/2026




**Dosja "Partizani", shtyhet seanca gjyqësore për Berishën**

11:13 : 14/09/2026



**Narkoshteti dhe farsa elektorale/ Berisha: SHBA ka potencialin për të na ndihmuar**

19:51 : 12/09/2026



**"Rama dhe Veliaj janë të tmerruar"/ Berisha: Kthimi im në SHBA përmbysi projektin e tyre**

21:40 : 10/09/2026



**Berisha-kongresmenit amerikan: Paratë e drogës po përdoren nga Rama për të manipuluar zgjedhjet**

18:34 : 09/09/2026

BOLD NEWS

**RRETH NESH**

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.
Na kontakto: [email protected]

**NA NDIQ**

2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.